

SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Përgjegjës Sektori për Start-Up'et	Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes	Tiranë	Pa afat	Po	Po	05.10.2023	20.10.2023

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Përgjegjës Sektori për Start-Up'et, në Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes
2. Kodi i pozicionit: N/A
3. Reparti/Institucioni: Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: VKM nr.325, datë 31.05.2023
6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat
7. Data e fillimit të aplikimit: 05.10.2023
8. Data e mbylljes së aplikimit: 20.10.2023
<p>9. Mënyra e aplikimit:</p> <p>Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën www.mod.gov.al. Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në:</p> <p><i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i></p> <p><i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i></p> <p><i>Tiranë</i></p>
10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar sëbashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike www.mod.gov.al.(linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: Përgjegjës Sektori për Start-Up’et në Sektorin e Start-up-ve, në Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes.
- b. Arsimi : Të ketë diplomë të nivelit “Master i shkencave” në degët Menaxhim Biznesi, Shkenca Ekonomike, Inxhinieri, Teknologji Informacioni dhe degë të tjera të ngjashme.
- c. Kualifikimi: Të ketë kualifikime në fushën e mësipërme.
- d. Trajnimi: Të ketë kryer trajnime të tjera që ndihmojnë në procesin e hartimit dhe zhvillimin e projekteve inovative (start up-eve).
- e. Eksperiencia në Punë: Përvojë në profesion, të paktën 5 (pesë) vjet.
- f. Gjuha e huaj: Anglisht
- g. Kërkesa të tjera specifike: Ekspertizë në fushën e start up-eve dhe zhvillimit të projekt ideve inovative. Aftësi për të përdorur programe të menaxhimit të projekteve, si Microsoft Project, Trello, Asana, Jira, programe të analizës së të dhënave, si Excel, R, Python, programe të

prezantimeve, si PowerPoint, Prezi, programe të komunikimit dhe bashkëpunimit, si Skype, Zoom, Slack.

- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: Te plotesoje kriteret për tu pajisur me certifikate të sigurimit të personelit, sipas VKM nr.188/2015. Certifikate Sigurie “Secret”.

- **Përshkrimi i punës:**

Detyrat kryesore:

- Organizon dhe koordinon veprimtarinë e sektorit dhe është përgjegjës për mirëfunksionimin e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
- Shpërndan punën midis specialistëve të sektorit për përmbushjen e detyrave në kohë dhe me cilësi.
- Nxiti projektet e paraqitura nga sektori për Projektet e Inovacionit, strukturave të Forcave të Armatosura, institucioneve të arsimit të lartë, personave fizikë dhe juridikë, vendas dhe ndërkombëtarë, që kanë për objekt të veprimtarisë inovacionin në fushat e shkencave natyrore, inxhinierie dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane, që lidhen me fushën e sigurisë dhe mbrojtjes;
- Mbështet krijimin dhe zhvillimin e startup-eve (Inkubatori i Startup-eve) duke siguruar mbështetje në të gjitha fazat e zhvillimit.
- Asiston dhe koordinon startup-et dhe sipërmarrësit e rinj në përdorimin e hapësirave dhe teknologjive të qendrës, si dhe shërbimeve të tjera të ofruara në qendër.
- Siguron akses të lehtë në Qendër për Forcat e Armatosura dhe partnerëve bashkëpunues.
- Promovon startup-et në organizatat e ndryshme brenda dhe jashtë Qendrës së Inovacionit.
- Bashkëpunon me sektori për Projektet e Inovacionit dhe partnerë të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit për të ndihmuar startup-et me këshillim/mentorim si dhe gjetjen e mundësive për mbështetje financiare.
- Harton skema dhe grafika për të krijuar raporte sipas nevojave;
- Krijon dhe menaxhon bazat e të dhënave dhe informacioneve për të cilat është përgjegjës.
- Hulumton, harton, implementon dhe menaxhon planin e punës për sektorin që drejton, në bashkëpunim me drejtorin dhe sektorët tjerë të Qendrës.
- Është përgjegjës për krijimin e dokumentacionit teknik për projektet e zhvilluara.
- Raporton në mënyrë periodike tek drejtori për zhvillimet e reja në Qendër.
- Përmbush në mënyrë të vazhdueshme afatet e përcaktuara.
- Siguron mbështetje për ekipin e tij.
- Siguron raporte të qarta dhe në kohë për statusin e zhvillimit të projekteve, problemet teknike dhe detaje të tjera relevante.

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.